



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 18 qershor 2010, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Naser Osmani, Riza Smaka, Synavere Rysha dhe Enis Kervan.

Munguan: Anita Morina-Saraçi dhe Gani Koci.

Të ftuar: Ekrem Hoxha – kryetar i Bordit të ART-së (mungoi), KRPP - Migjen Selmani, APP – Mursel Raci, OSHP – Sabrije Bullatovci.

Të pranishëm: Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, Musa Rudaku – zyrtar i fushës për ekonomi dhe financa, KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe i Raportit të Auditorit të Pavarur – Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit,**
3. **Prezantimi i përmbushjes së sfidave të dala nga Raporti i Progresit për: Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Agjencinë Publike të Prokurimit dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe i Raportit të Auditorit të Pavarur – Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit

Kryesuesi – Për pikën e parë të rendit të ditës tha se është ftuar me kohë kryetari i Bordit të ART-së, për të marrë pjesë në këtë mbledhje. Propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet edhe në mungesë të përfaqësuesve të ART-së. Sa i përket Raportit, Auditori i ka cilësuar këto pasqyra të drejta, nuk ka konstatuar ndonjë shkelje. Hap diskutimin.

Synavere Rysha – Të brengosë mosprania e kryetarit të Bordit të ART-së, sepse pikërisht çështja kryesore që do të duhej të shqyrtohej në këtë mbledhje është raporti i ART-së. Ka rreth dy vjet që në Kuvendin e Kosovës po debatohet çështja e 16 milionë eurove pagesë – “Kompanisë DardaPhone”. Ky Komision do të kishte njoftimin më të saktë dhe më konkret nga kryetari i Bordit të ART-së.

Edhe me këtë raport nuk janë përmbushur kriteret e raportimit në Komision. Këto raporte përcillen me parregullsi - është vetëm një logo e një kompanie që e ka bërë auditimin. Këtij raporti i mungon nënshkrimi i auditorëve që e kanë bërë auditimin, po ashtu i mungon nënshkrimi i drejtorit për pasqyrat financiare. Pra, askush nuk ka marrë përgjegjësi për këto pasqyra. Nëse i referohemi faqes, në të cilën flitet për standardet e kontabilitetit, të cilat janë përdorur, vërtet del se gjithçka është në rregull. Sa u përket shpenzimeve, shihet se disa paga janë të larta, pozicioni mallra dhe shërbime është përafërsisht i njëjtë me atë të pagave, por përderisa këto çështje nuk janë rregulluar me ligj, ne i kemi lënë hapësirë të mjaftueshme secilës agjenci që të punojë në mënyrën e vet.

Safete Hadergjonaj – Tha se asnjë raport i auditimit që është proceduar në Komision nuk është dashur të pranohej, sepse në këto raporte asnjë shënim nuk është i hollësishëm ose i pasqyruar në këtë raport. Ndoshta standardi i raportimit të agjencive është i tillë, mirëpo me raporte të tilla Komisioni nuk mund të japë konstatime. Nuk mund ta kalojmë vetëm thjesht si raport.

Riza Smaka – Forma është garanci e rregullsisë së një dokumenti. Në qoftë se dokumenti i caktuar nuk e ka formën e kërkuar, nuk është dokument, nuk ka vlerë, nuk ia vlen të trajtohet në këtë Komision. Çështjet duhet të saktësohen. P.sh. mallrat dhe shërbimet, pagat dhe rrogat - ku qëndron dallimi ndërmjet tyre? Këto janë shumë të larta nëse krahasohet viti 2008 me vitin 2009. A ka ndonjë kriter për këtë, apo jo? Tepriçat e krijuara nga taksat, licencat dhe autorizimet janë më shumë se shuma e buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. A do të transferohen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës? Pse nuk janë transferuar deri më tani?

Kryesuesi – Sipas Raportit të auditorit të gjitha pasqyrat financiare janë paraqitur si duhet. Edhe bilancet e llogarive në thesar janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Këtë e garanton kompania me autoritetin e vet që e ka bërë auditimin. Raporti është i hollësishëm, si për të hyra, shpenzime, mallra e shërbime dhe kategoria e shpenzimeve kapitale etj. Duhet të respektohet mendimi i kompanisë audituese. Propozoj të përkrahet ky Raport dhe në seancë plenare të shqyrtohet së bashku me raportet e dy komisioneve të tjera funksionale.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja, njëzëri e nxori këtë

REKOMANDIM

Të miratohen pasqyrat financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur – Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit.

Shqyrtimi i Raportit të bëhet së bashku me raportet e dy komisioneve të tjera funksionale në seancë plenare.

3. Prezantimi i përmbushjes së sfidave të dala nga Raporti i Progresit për: Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Agjencinë Publike të Prokurimit dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm

Kryesuesi – Sipas Planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës, KMFP-ja duhet të organizojë dëgjim publik me Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik, me Organin Shqyrtues të Prokurimit, me Agjencinë Publike të Prokurimit, me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, përkitazi me sfidat që dalin nga Raporti i Progresit - fusha e prokurimit. Hap diskutimin.

Migjen Selmani - KRPP – I njoftoi anëtarët e Komisionit për veprimet e ndërmarra për sfidat e dala nga Raporti i Progresit. Tha se ka filluar ndryshimi i Ligjit për prokurimin publik në Kosovë, nr. 02/L-90, i cili do të rishkruhet në tërësi. Grupi i punës i ka pranuar gjithsej 176 propozime nga autoritetet kontraktuese qendrore dhe lokale, nga kompanitë publike, nga Oda Ekonomike e Kosovës, nga OJQ-të etj, për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik. Grupi i punës parashih që deri në fund të qershorit të vitit 2010, ta përfundojë në tërësi rishikimin e LPP-së. Në kuadër të KRPP-së, prej shtatorit 2009, funksionon tavolina ndihmëse, me qëllim që t'u jepen sqarime autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë. Gjithashtu nga KRPP-ja janë hartuar dhe kanë hyrë në fuqi *“doracakët për prokurim publik I-IX”*. Në bazë të planit të hartuar po nga Departamenti i Monitorimit dhe i Mbikëqyrjes, në kuadër të KRPP-së, vetëm për periudhën e këtij viti fiskal e deri më sot, janë mbikëqyrur 16 autoritete kontraktuese. Tashmë të gjitha raportet janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të KRPP-së. www.ks.gov.net/krpp/. Gjatë muajit prill 2010, KRPP-ja, në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë, në kuadër të projektit për prokurim publik në Kosovë, i ka përfunduar dosjet e tenderit për kontrata publike kornizë. Këto dosje janë miratuar dhe janë shpallur në faqen e internetit të KRPP-së.

Riza Smaka – Tha se duhet të bëhet një ripunim serioz i Ligjit të prokurimit. Çështja e avancit ilegal, duhet të normohet disi, pastaj kontratat plotësuese, çështja e hulumtimit të sofistikuar të zbatimit të kontratave dhe tenderët njëburimorë, duhet të trajtohen seriozisht në këtë Ligj. Duhet të kemi kujdes që dokumenti i parë i rishkrimit të ligjit të bëhet si duhet, sepse në Kuvend paraqiten vështirësi të mëdha.

Migjen Selmani - KRPP – I njoftoi anëtarët e Komisionit se sipas Raportit të Progresit ka vërejtje edhe për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave publike. Nëse arrihet të futet në ligjin e ri kjo çështje, do të mbyllet një kapitull shumë i veçantë, që ka ndikuar në keqpërdorimin e kontratave publike, sepse me ligjin aktual KRPP-ja i mbikëqyrë këto kontrata vetëm deri në nënshkrimin e tyre.

Mursel Raci - APP – I paraqiti hapat e ndërmarrë nga APP-ja për sfidat e dala nga Raporti i Progresit. Tha se është bërë riorganizimi i brendshëm i APP-së. Ky riorganizim ka kërkuar edhe bazën e vetë ligjore, që e nënkupton domosdoshmërinë e hartimit të një rregulloreje të re të punës. APP-ja, në harmoni me nenin 92.2 të Ligjit Nr. 02/L 99 për Prokurimin Publik, si dhe me rekomandimet e Komisionit Evropian për APP-në, i ka bërë të gjitha përgatitjet për t'i ushtruar aktivitetet e prokurimit lidhur me furnizime të përbashkëta për institucionet e Republikës së Kosovës. APP-ja ka identifikuar furnizime të përshtatshme, mirëpo këto aktivitete nuk kanë mundur të realizohen për shkak të mungesës së dokumentacionit standard për kontratat kornizë. Lidhur me këtë, APP-ja ka bërë kërkesë në KRPP që të hartohet dokumentacioni standard i kontratave kornizë dhe tani janë në pritje të këtij dokumentacioni. Në harmoni me kërkesat e Ligjit nr. 02/L-99 për prokurim publik, për transparencë publike në menaxhimin e fondeve publike, APP-ja e ka për objektiv ndërtimin e një aplikacioni elektronik bashkëkohor, i cili do t'u mundësonte qasje elektronike në aktivitete të APP-së, të gjithë të interesuarve dhe njëkohësisht do të ishte një bazë e mirë për t'i filluar hapat e parë drejt *E-prokurimit* edhe në Kosovë. Një element tjetër që ka ndikuar në vonesë, në këtë drejtim, është mungesa e drejtorit ekzekutiv të APP-së. Ndryshimet e LPP-së, që janë në proces, paraqesin ndryshime jashtëzakonisht të mëdha, si në fushën e përgjegjësiwe të APP-së, ashtu edhe në atë funksionale.

Prandaj APP-ja prit zgjidhje ligjore, që organizimin e saj ta bëjë në përputhje me kërkesat e reja të LPP-së.

Kryesuesi – *Sa është e angazhuar APP-ja për të ardhmen e saj, në procesin e ribërjes së ligjit?*

Migjen Selmani – KRPP - Tha se me Ligjin 2003/17, udhëheqja e APP-së, përbëhet nga tre anëtarë të Bordit, njëri nga këta tre anëtarë është drejtor ekzekutiv. Me ndryshimin e Ligjit 2L/79 parashihet që APP-ja të udhëhiqet nga një drejtor ekzekutiv i propozuar na Qeveria dhe i miratuar në Kuvendi. Me rishkrimin Ligjit me siguri se do të ketë ndryshime.

Safete Hadergjonaj - Pati vërejtje për Komisionin e Integriteteve Evropiane, i cili gjatë përgatitjes së Planit të veprimit duhet t'i konsultojë komisionet e tjera të Kuvendit, që të mos përzihen kompetencat e komisioneve. KMFP-së i duhen përgjigje konkrete, për ta ditur a janë apo nuk janë përmbushur nga këto institucione sfidat e dala nga Raporti i Progresit. *Çka mund të ndërmarrë Kuvendi për përmbushjen e këtyre obligimeve nga këto institucione?*

Enis Kervan – Tha se sipas Raportit të Progresit, kapacitetet administrative janë dobësuar. Sipas përfaqësuesve të APP-së janë punësuar dy drejtorë. *A e nënkupton përmbushja e kësaj sfide vetëm punësimin e kuadrove apo si qëndron kjo çështje?*

Mursel Raci – Sipas Raportit të Progresit, çështja ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve të APP-së. Sa u përket prokurimeve njëburimore, ka rënë niveli i tyre.

Synavere Rysha – Nëse këto tri institucione, KRPP-ja, OSHP-ja dhe APP-ja, me rishkrimin e ligjit kanë paraparë të bashkohen në një institucion dhe pastaj brenda tij të bëhet hierarkia e tyre, me qëllim të funksionalizimit më të ngushtë të këtyre institucioneve. Raporti i Progresit dobësi kryesore ka paraparë ligjin jo të përshtatshëm.

Sabrije Bullatovci - OSHP – E paraqiti përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit për OSHP-në. Lidhur me publikimin e vendimeve të paneleve shqyrtuese - viti 2008, tha se në këtë kohë OSHP-ja ka qenë në konsolidim e sipër dhe publikimi i vendimeve ka qenë i pamundur. Mirëpo, nga shkurti i vitit 2009, të gjitha vendimet e paneleve shqyrtuese janë publikuar në faqe të internetit. Me qëllim të përmirësimit të sistemit të publikimit të vendimeve, OSHP-ja e ka filluar aktivitetin e prokurimit për avancimin e faqes së internetit të saj, në përputhje me standardet moderne.

Çdo vendim që merret nga panelet shqyrtuese, në mënyrë recidive, i specifikon nenet e LPP-së, ose të legjislacionit dytësor, të cilat janë shkelur nga autoritetet kontraktuese. Edhe për çdo ankesë, pasi të merret rekomandimi nga eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të provave, verifikimit të gjendjes faktike dhe ligjore, nga panelit merret një vendim meritator, i cili në vete përmban: pjesën hyrëse, dispozitivin dhe arsyetimin e ecurisë procedurale.

Lidhur me komentin e deputetes Synavere Rysha, ajo tha se OSHP-ja kurrë nuk mund të jetë bashkë në një institucion me KRPP-në dhe me APP-në, sepse përbën konflikt interesi. Kjo është paraparë edhe me direktiva evropiane.

Synavere Rysha – Tha se KRPP-ja dhe APP-ja duhet të jenë në një institucion - agjenci, pastaj OSHP-ja del nga ky institucion.

Migjen Selmani - Sipas rekomandimit të Komisionit Evropian, APP-ja po shkon rrugës që të krijohet si organ qendror i blerjes, për të gjitha institucionet. Kjo nuk e lejon që APP-ja të jetë në kompetencë të KRPP-së, e aq më pak të OSHP-së.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm - E dorëzoi me shkrim kontributin e ZAP-it për Raportin e Progresit.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

KMFP-ja ta përgatitë një raport për Komisionin për Integritet Evropian në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:22

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Haki Shatri